

VENDIM
Nr. 587, datë 1.7.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR
PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Prokurorisë së Përgjithshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, në kategorinë e shpenzimeve operative, i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh për mbulimin e rritjes së pagave të punonjësve të shërbimit privat të sigurisë fizike.
2. Prokurorisë së Përgjithshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, në kategorinë e shpenzimeve korrente, i shtohet fondi prej 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milionë) lekësh për mirëmbajtjen e sistemit informatik të saj dhe aplikacioneve të konfiguruar në këtë sistem.
3. Efekti financiar, i parashikuar në pikat 1 e 2, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.
4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Prokuroria e Përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama